



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 34, datë 26. 05. 2022

**“PËR MERATIMIN E VEND DEPOZITIMIT TË MBETJEVE URBANE, PËR
BASHKINË SKRAPAR”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 26. 05. 2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Drejtoria e Zhvillimit të Territorit, Kadastrës, Mjedisit dhe Ujitjes në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 3, gërma "e", neni 23, pika 10, neni 26, pika 1. Ligjit Nr.107, datë 31.07.2012, "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Ligjit Nr.10431, datë: 09. 06. 2011, "Për mbrojtjen e Mjedisit", si dhe Ligjit Nr.10463, datë: 22. 09. 2011, "Për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve",

VENDOSI:

1. Vend depozitimi për mbetjet urbane në Bashkinë Skrapar, të jetë në Pasurinë me numër 71, me sipërfaqe totale 18100 m², zona kadastrale 1420, qyteti Çorovodë, në pronësi – shtet, e cila ndodhet në vendin e njohur me toponimin "Përroi i Pilipizgës", poshtë rrugës, rreth 2 km largë nga qyteti Çorovodë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Zhvillimit të Territorit, Kadastrës, Mjedisit dhe Ujitjes.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 11 vota pro , vota kundër - s'ka , vota abstenim – s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

